

**URDHËR**  
**Nr. 467, datë 27.11.2018**

**PËR HAPJEN E THIRRJES SË PARË PËR APLIKIME**  
**PËR PROGRAMIN IPARD II**

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar, në Marrëveshjen Kuadër, Marrëveshjen Sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjen e Financimit,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e Thirrjes së Parë për aplikime nga Programi IPARD II, për aplikimet, respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin dhe transparencën, me qëllim garantimin e vizibilitetit dhe llogaridhënien e fondeve të BE-së.

2. Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në “Udhëzuesin për Aplikantët” lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohet si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00-16:30.

3. Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të **shkarkohen në versionin zyrtar nga data 30 nëntor 2018** nga faqja e internetit: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al) dhe <http://www.bujqesia.gov.al>.

4. Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 30 nëntor 2018 deri në datën 30 janar 2019 sipas orarit zyrtar 08:00 -16:30.

5. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në zarfe të mbyllura me titullin *Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve*, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin **“Të mos hapet përpara dorëzimit”**.

Aplikimet duhet të dorëzohen:

- nëpërmjet dërgesës postare rekomande; ose
- dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga: Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, rruga “Muhamet Gjollesha”, nr. 56, Tiranë, Shqipëri.

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo *e-mail*) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**  
**Frida Krifca**